



# RAPORTI I RI I KE-SË: PA SURPRIZA

## ANALIZË E SHKURTËR E RAPORTIT TË KE-SË PËR MAQEDONINË E VERIUT PËR VITIN 2021<sup>1</sup>

Prezantimi i paketës së zgjerimit në Komisionin e Politikës së Jashtme nga Komisioneri Varheji ishte dukshëm nën hijen e procesit të bllokuar të pranimit të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë dhe pamundësisë së shteteve anëtare për të vendosur mbi fillimin e negociatave me të dy vendet.

Në këto rrethana, Komisioni mbetet i sigurt sa i përket gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore tashmë të njohura në lidhje me hapjen e negociatave. Në Përfundimet e Strategjisë së Zgjerimit të këtij viti, Komisioni përsërit se shtyrja e fillimit të negociatave me të dy vendet **NDIKON NEGATIVISHT NË BE-SUESHMËRINË E BE-SË**. Prandaj, ai bën thirrje që çështjet dypalëshe midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut të zgjidhen si prioritet, që shtetet anëtare të përfundojnë diskutimin mbi kornizën negociuese dhe konferencat e para ndërqeveritare që do të mbahen para fundit të këtij viti. Kjo këmbëngulje mbështetet nga vlerësimi se vendi ka përmbushur kushtet për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare, falë “mbajtjes së një ritmi të qëndrueshëm dhe vendimtar në zbatimin e reformave të BE-së, veçanërisht në fushat kryesore si sundimi i ligjit, përfshi luftën kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar”.

Edhe pse Raporti është modifikuar metodologjikisht - tani është plotësisht i strukturuar sipas grupeve, dhe në thelb nuk ka asnjë risi të madhe në qasjen e Komisionit përveç renditjes së kapitujve dhe përmbledhjes së gjetjeve kryesore sipas kapitujve. Në shumicën e grupeve, Maqedonia e Veriut vlerësohet si e përgatitur mesatarisht për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE me dallime të dukshme midis kapitujve specifikë në kllasterë, siç mund të shihet nga tabela më poshtë.

---

<sup>1</sup> Përveç kësaj analize të shkurtër, Instituti për Politikë Evropiane po përgatit një analizë të detajuar të raportit dhe rekomandimeve me një krahasim të tendencave që do të publikohen në ditët në vijim.



VËMENDJA MË E MADHE NË RAPORT I KUSHTOHET **GRUPIT 1. THEMELORËT.**

RAPORTI ËSHTË PËRGJITHËSISHT **POZITIV SA I PËRKET INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE.**

Mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Qeverisë për reformat në lidhje me integrimin në BE - kontrollet dhe balancat e aktivizuara dhe një gamë të gjerë temash mbi politikat kryesore dhe çështjet legjislative, funksionimin e Parlamentit pavarësisht polarizimit politik, dhe marrëdhëniet e qëndrueshme ndëretnike, si dhe gjykimet e ngjarjeve të 27 prillit të vitit 2019. Identifikimi i shoqërisë civile si aktor kyç nga institucionet shtetërore është mirëpritur gjithashtu.

Shumica e «dhimbjeve» të vjetra janë konstatuar përsëri, të tilla si, për shembull, ndryshimet në Kodin Zgjedhor pak para zgjedhjeve, një numër ligjesh me procedurë të shkurtuar, nisma të reja sporadike në vend të zbatimit të kornizës ligjore ekzistuese, ndërprerja e procesit të reformës së vetëqeverisjes.

Për dallim nga gjetjet dhe rekomandimet lidhur me institucionet demokratike në lidhje me reformën në administratën publike, rekomandimet kryesore i referohen ndryshimit të ligjeve relativisht të reja sistematike të miratuara me mbështetjen e KE-së dhe miratimit të atyre të reja, në vend që të fokusohen në zbatimin.

Situata në fushën e të drejtave themelore është shqetësuese nga aspekti i zbatimit. Problemet kronike që vazhdojnë në zona të caktuara përsëriten, siç është situata në burgje dhe zbatimi i dobët i rekomandimeve të Komitetit kundër torturës. Për më tepër, edhe pse situata me lirinë e shprehjes vlerësohet si përgjithësisht e mirë, reformat në sferën e mediave janë të ngadalta. Rimiratimi i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësohet, por me pritje për forcimin e organit të ri të pavarur, të zgjedhur në mënyrë transparente, e formuar pikërisht për këtë qëllim.

Në luftën kundër korrupsionit, Raporti është i detajuar në prezantimin e rezultateve të rasteve (lëndëve), veçanërisht ato të profilin të lartë, me një konstatim pozitiv për vazhdimin e rasteve nga ish PSP-ja. Komisioni përsërit vlerësimet pozitive të Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit. Komisioni në masë të madhe vlerëson forcimin e institucioneve në Kapitullin 24. Drejtësia, Liria dhe Siguria, si dhe rezultatet e përmirësuar në rastet e krimit të organizuar. Është bërë përparim i mirë në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar mbi reformën institucionale të sektorit të sigurisë, si dhe reformën e shërbimeve të inteligjencës.

Raporti është përgjithësisht pozitiv për sa i përket trajtimit të autoriteteve ndaj sfidave ekonomike të COVID, si dhe rritjes së mëtejshme të transparencës fiskale, por paralajmëron për rritjen e borxhit publik, reformat e ngadalshme strukturore ekonomike dhe shpenzimet e ulëta kapitale.

Të tre kapitujt që i përkasin Grupit - Themeloret mbeten “mesatarisht të përparuar”, dhe i vetmi përparim i mirë nga viti i kaluar u vërejt në Kapitullin - Statistika, për shkak të vlerësimit pozitiv të përgatitjes dhe zbatimit të procesit të Regjistrimit. Dy kapitujt e tjerë - Prokurimet publike dhe Kontrolli financiar kanë bërë përparim të kufizuar.

Për herë të parë, një shtojcë (aneks) e **STRATEGJISË SË ZGJERIMIT SIGURON NJË PASQYRË TË IND-KATORËVE DHE INDEKSEVE NDËRKOMBËTARE** që Komisioni do të përdorë në vlerësimin e gjendjes së institucioneve demokratike dhe sundimit të ligjit. Këto përfshijnë vlerësimet vjetore të Freedom House, Transparency International, Bankës Botërore dhe Reporterëve pa Kufij. Shumëllojshmëria e tyre tregon qartë vështirësitë në vendosjen e standardeve dhe vlerësimeve të identifikueshme në këto fusha. Përveç kësaj, është e qartë se qasja ndaj raportit është më teknike dhe Komisioni shmang vlerësimet politike, gjë që nuk ka qenë gjithmonë rasti në të kaluarën.

**NË GRUPIN 2: TREGU I BRENDSHËM**, i cili përbëhet nga kapituj me *acquis* të gjerë dhe kompleks, përparii është i kufizuar ose nuk ekziston, me përjashtim të ndryshimeve të vogla sa i përket lëvizjes së lirë të kapitalit dhe të drejtës së shoqërive tregtare. Shqetësuese është stagnimi i vazhdueshëm në kapitullin e rëndësishëm numër 8 - Konkurrenca. KE-ja e lidh këtë grup në vlerësimin e tij me detyrimet e anëtarësimit në tregun e përbashkët të BE-së, por edhe në Tregun e përbashkët rajonal.

**NË GRUPIN 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA GJITHËPËRFSHIRËSE** ka stagnim të konsiderueshëm, me përjashtim të Kapitullit 29: Bashkimi Doganor i cili është përsëri një përjashtim pozitiv me përparim të vazhdueshëm. Vlerësimet e masave për të mbështetur ekonominë dhe punësimin janë të favorshme, por kriza po ndikon gjithashtu në ngadalësimin e politikave sociale dhe reformave në arsim. Pothuajse në të gjithë kapitujt mungon pavarësia, koordinimi dhe kapaciteti i institucioneve, por edhe mungesa e burimeve dhe përpjekjeve për zbatimin e ligjeve dhe politikave.

**NË GRUPIN 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHJA E QËNDRUESHME**, Kapitulli 15 - Energjia shënon një vlerësim pozitiv sa i përket tregut të energjisë, por mbetet prapa në fushën e efikasitetit energjetik. Stagnim ka në Kapitullin 14 - Politika e komunikacionit (trafikut), si dhe në Kapitullin kompleks 27 - Mjedisi jetësor. Shqetësim i veçantë lind gjithashtu nga fakti se këta kapituj janë një pjesë e rëndësishme e Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

**NË KLLASTERIN 5: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI**, nga njëra anë, janë kapitujt në të cilët ne bëjmë përparim të vazhdueshëm si Kapitulli 12 - Siguria e ushqimit, në krahasim me kapitujt në të cilët kemi ngecje ose përparojmë shumë ngadalë si Kapitulli 22 - Politika rajonale dhe koordinimi strukturor i instrumenteve, si dhe Kapitulli 32 - Dispozitat financiare dhe buxhetore. Konstatimet e vazhdueshme në lidhje me kapacitetin e reduktuar për përdorimin e mjeteve financiare nga fondet e BE-së dhe vonesat në zbatimin e projekteve më të rëndësishme janë shqetësuese.

**GRUPI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME** po shënojnë progres për shkak të rritjes së përputhshmërisë me pozicionet e BE-së (96%) dhe pjesëmarrjes sonë në misionet e BE-së. Ende mungon një kornizë politikash për ndihmën zhvillimore dhe humanitare.

**SHEMBUJT POZITIVË** që tregojnë vazhdimisht rezultate të mira mbeten Kapitulli 12: Siguria e ushqimit, politika veterinarë dhe fitosanitare dhe Kapitulli 29: Bashkimi doganor. Kapitulli 12 ka një nivel të mirë gatishmërie, i cili është ruajtur që nga viti 2016, por këtë vit, si vitin e kaluar ka edhe një "përparim të mirë". Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh kompleksitetin e kapitullit (shpesh konsiderohet si kapitulli më i vështirë në zbatimin e *acquis*). Situata është e ngjashme me Kapitullin 29: Bashkimi doganor, në të cilin ne gjithashtu kemi bërë progres të mirë, dhe Komisioni vëren se legjislacioni në fushën e doganave është në një nivel të lartë të pajtueshmërisë me *acquis* evropiane.

Në këtë raport janë vërejtur gjithashtu disa paralajmërime për disa raste mospërputhjeje me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Në përgjithësi, përsa i përket vlerësimeve të gatishmërisë në kapitujt, nuk ka ndryshime nga viti 2019, dhe ndryshime mjaft të vogla në krahasim me vitet e mëparshme. Edhe pse kemi bërë përparim në të njëjtën periudhë, veçanërisht në kapitujt të caktuar, ai nuk reflektohet në rritjen e vlerësimit të gatishmërisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Kjo situatë reflekton natyrën afatgjatë të procesit të pranimit, ndryshimin e vazhdueshëm të legjislacionit evropian, por edhe mungesën e përgjithshme të mbështetjes politike në BE për procesin e zgjerimit. Nga pikëpamja e një vendi kandidat, një qasje e tillë nuk jep impulse për reforma.

## ANEKS 1: NIVELI I KONSOLIDIMIT DHE PËRPARIMIT<sup>2</sup>

GRUPI	SFERA/KAPITULLI	GATISHMËRI					PËRPARIM		
		2015	2016	2018	2019	2020	2021	2019-2020	2020-2021
1. THEMELORET	FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMAT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE								
	• REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE	3	3	3	3	3	3	2	2
	23. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE	2	2	2	2.5	2.5	2.5	3	2
	• FUNKSIONIMI I GJYQËSORIT	2	2	2	2.5	2.5	2.5	3	2
	• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT	2	2	2	2	2.5	2.5	3	2
	• LIRIA E SHPREHJES	2	2	2	2.5	2.5	2.5	1	1
	24. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	3	3	3	3	3	3	3	2
	• LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR	2	2	2	2	2	2	2	2
	LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR	4	4	4	4	4	4	1	2
	AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR PRESIONIN KONKURRUES DHE FORCAT E TREGUT NË BE	3	3	3	3	3	3	2	2
	5. PROKURIME PUBLIKE	3	3	3	3	3	3	2	1
	18. STATISTIKË	3	3	3	3	3	3	3	3
32. KONTROLLI FINANSIAR	3	3	3	3	3	3	2	1	
2. TREGU I MBRENDSHËM	1. QARKULLIMI I LIRË I MALLËRAVE	3	3	3	3	3	3	0	1
	2. LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE	1	1	1	1	1	1	0	0
	3. E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE	3	3	3	3	3	3	2	0
	4. LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT	3	3	3	3	3	3	2	2
	6. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE	4	4	4	4	4	4	2	2
	7. E DREJTA E PRONËS INTELEKTUALE	3	3	3	3	3	3	2	2
	8. POLITIKA E KONKURRENCËS	3	3	3	3	3	3	0	0
	9. SHËRBIMET FINANSIARE	3	3	3	3	3	3	1	1
	28. MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE	3	3	3	3	3	3	0	0
	3. KONKURRUESHMËRIA DHE RRIJTJA GJITHËPËRFSHIRËSE	10. SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIAT	4	4	3	3	3	3	2
16. TATIMET		3	3	3	3	3	3	2	2
17. POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE		3	3	3	3	3	3	2	2
19. POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI		3	3	3	3	3	3	2	2
20. NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE		3	3	3	3	3	3	2	2
25. SHKENCA DHE HULUMTIMI		4	4	4	4	4	4	2	1
26. ARSIMI DHE KULTURA		3	3	3	3	3	3	2	1
29. BASHKIMI DOGANOR		4	4	4	4	4	4	3	3
4. AGJENDA E GJELBËR DHE QËNDRUESHMËRIA	14. POLITIKAT E KOMUNIKACIONIT	3	3	3	3	3	3	1	1
	15. ENERGJIA	3	3	3	3	3	3	3	2
	21. RRJETET TRANS-EUROPIANE	4	4	4	4	4	4	1	1
	27. MJEDISI JETËSOR	3	2	2	2	2	2	1	1
5. BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZION	11. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL	3	3	3	3	3	3	3	2
	12. SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE	2	2	4	4	4	4	3	3
	13. PESHKIMI	3	3	3	3	3	3	1	0
	22. POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE	3	3	3	3	3	3	2	1
	33. DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE	1	1	1	1	1	1	1	1
6. MARRËDHËNIET E JASHTME	30. MARRËDHËNIET E JASHTME	3	3	3	3	3	3	2	2
	31. POLITIKA E JASHTME, SIGURISË DHE MBROJTJES	3	3	3	3	3	3	2	2

2 Janë treguar sferat dhe zonat për të cilat Raporti siguron nota uniforme që mund të përcaktohen.

## Rishikimi i notave për gatishmëri

ASSESSMENT	NUMERICAL VALUE/VLERA NUMERIKE	NOTA
AT AN EARLY STAGE	1	NË FAZË TË HERSHME
SOME LEVEL OF PREPARATION	2	MESATARISHT I GATSHËM
MODERATELY PREPARED	3	MESATARISHT I GATSHËM
GOOD LEVEL OF PREPARATION	4	NIVEL I MIRË I GATISHMËRISË
WELL ADVANCED	5	GATISHMËRI SOLIDE

## Vlerësim i notave për përparim

ASSESSMENT	NUMERICAL VALUE/VLERA NUMERIKE	NOTA
BACKSLIDING	(-4)-(-1)	KTHIM MBRAPA
NO PROGRESS	0	NUK KA PËRPARIM
LIMITED PROGRESS	1	PËRPARIM I LIMITUAR
SOME PROGRESS	2	NIVEL I CAKTUAR I PËRPARIMIT
GOOD PROGRESS	3	PËRPARIM I MIRË
VERY GOOD PROGRESS	4	PËRPARIM SHUMË I MIRË